



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kabineti i Kryetarit të Komunës së Prizrenit
Drejtoria për Ekonomi e Financa
Datë 11 Maj 2021
Prizren

DËGJIMI I PARË PUBLIK PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE
(KAB) 2022-2024
ME TEMË “TAKIM ME ORGANIZATA”

P R O C E S V E R B A L

Komuna e Prizrenit do të organizojë katër dëgjime publike lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024.

Në këto dëgjime mëtojmë të marrim opinionin e qytetarëve për projektet vijuese të komunës sonë, shërbimet komunale dhe kërkesat tjera eventuale.

Dëgjimet do të organizohen me pjesëmarrje të kufizuar fizike, për shkak të situatës pandemike, ndërkaq për të mundësuar sa më shumë pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje, këto dëgjime do të organizohen edhe në formën “online” përmes aplikacionit ZOOM.

Informacionet më të hollësishme në lidhje me dëgjimet publike dhe linqet për pjesëmarrje nëpërmjet platformës ZOOM i kemi bërë publike njëzet ditë më parë në Ueb faqe të komunës, FB, Instagram, TV- lokale, Radio Lokale e platforma tjera.

Po ashtu qytetarët janë njoftuar në vazhdimësi për mbajtjen e këtyre dëgjimeve, si nga mediat lokale, ashtu edhe nëpërmjet faqes dhe rrjeteve sociale të Komunës së Prizrenit.

Për pjesëmarrje në dëgjime publike të qytetarëve dhe të tjerëve të interesuar, në vijim japin linqet për kyçje, në të gjitha gjuhët zyrtare në komunën tonë.

Për gjuhën shqipe: <https://kk.rks-gov.net/.../04/Degjime-publike-KAB.pdf...>

Për gjuhën turke: <https://kk.rks-gov.net/.../26/2021/04/ORTA-VADELI-KAB.pdf>

Për gjuhën srb/bosh.: <https://kk.rks-gov.net/.../JAVNE-DEBATE-O-SREDNJOROCNOM...>

Dëgjimet publike mbahen në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (në Shtëpi të Bardhë) dhe janë të publikuara: Koha e mbajtjes (ora), data dhe detajet tjera të nevojshme.

Të ftuar:

- Përfaqësuesit e Kuvendit të Komunës së Prizrenit,
- Qytetarët,
- Organizatat Ndërkombëtare,
- Përfaqësuesit e OJQ-ve të Komunës së Prizrenit,
- Përfaqësuesit e shoqatave të bizneseve të Komunës së Prizrenit,
- Mediet lokale të Komunës së Prizrenit.

Meqë tema e dëgjimit të parë është “Takim me organizata”, i është kushtuar një rëndësi të veçantë që nëpërmjet e-mailit të ftohen drejtpërdrejtë përfaqësues të organizatave dhe të shoqërive të ndryshme civile nga Komuna e Prizrenit.

Dëgjimin e parë publik me qytetarët e moderoi drejtoresha për Ekonomi e Financa znj. Leonora Çerreti dhe prezantoi planifikimet dhe parashikimet buxhetore të komunës sonë për vitin 2022.

Buxheti për vitin 2022 do të jetë 52.874.349.00 euro, 11 %, rritje krahasuar më vitin paraprak.

Më tej, drejtoresha njoftoi për buxhetin komunal për subvencionet, duke dhënë informacione të hollësishme në lidhje me vlerat e ndara gjatë tre viteve të fundit për OJQ dhe shoqatat e ndryshme.

Pas prezantimit të planifikimit të buxhetit për vitin vijues, drejtoresha znj. Leonorë Çerreti hapi diskutimin më të pranishmit në sallë dhe ata të cilët përcillnin debatin online.

Fjalën për diskutim e kërkoi z. Besim Kodra, nga shoqata e të drejtave të pacientëve në Kosovë dhe vazhdoi:

“Pashë ndarjen e fondeve të komunës për OJQ-të dhe pjesa dërmuese shkonte në kulturë, rini dhe sport, por ajo që më befaso i shumë ishte se nuk kishte fare grante nga drejtorja e shëndetësisë, pra DSH, fare nuk kishte grante, e sipas ligjeve komuna e ka në përgjegjësi të saj kujdesin primar shëndetësor dhe mjekësinë preventive: si është e mundur që fare të mos përfshihet Drejtorja e Shëndetësisë në shpërndarjen e fondeve për OJQ dhe të tjerë në ngritjen e vetëdijes së qytetareve për mbrojtjen e shëndetit sidomos tani që jemi në kohë pandemie. Pa bashkëpunim ndërinstitucional dhe qytetar vështirë luftohet pandemia

A ka mundësi që të ndahen fonde dhe të zhvillohen aktivitete për luftimin e pandemisë?”

Leonora Cerreti:

Arsimi dhe shëndetësia kanë fonde të ndara dhe sigurohen nga niveli qendror qeverisës.

Sibel Vezej:

Drejtoria e Shëndetësisë i subvencionon te sëmuret me kancer dhe s'mundje tjera të ndryshme. Vetëm gjatë vitit të kaluar DSH-ja, i ka subvencionuar 320 pacientë.

Visar Haxhifazliu

E konsideroj te rëndësishëm debatin dhe faleminderit për ftesën. Unë mendoj që rinia duhet të përkrahët ndaras nga kultura dhe sporti në mënyrë që të përfitojë më shumë rinia. Po ashtu te rinjtë e Prizrenit nuk kanë hapësira për aktivitetet rinore dhe ftoj komunën të ndaj një buxhet për ndërtimin e qendrave të reja rinore në Prizren dhe në fshatra. Një buxhet prej 50.000 euro mendoj do mjaftonte për mirëmbajtjen, aktivitetet dhe shpenzimet tjera administrative të qendrave rinore.

Haki Reshtana

Përfaqësoj komuniteti Turk, Unë si prind kam pas telashe me covid-19, dhe kërkoj që komuna të kujdeset për qytetaret e saj. E kam thirr urgjencën dhe nuk kanë mundur të vijnë më ma kontrolluar nënën, me i marr analizat e testet tjera për shkak të infektimit të mundshëm me covid. Ju lutem të jeni me afër njerëzve të vjetër dhe të sëmurëve.

Te varrezat kemi telashe gjatë ceremonisë së varrimit dhe në komunikacion etj. Së dyti propozoj për rini një Qendër Kulturore Turke. Te rruga Remzi Ademaj kemi telashe me trotuarin, a do marrin zgjidhje këto probleme?

Sibel Vezej,

Duhet të ju njoftoj se Komuna e Prizrenit është komuna e parë që ofron shërbimin geriatrik për të moshuarit, vetëm vitin e kaluar janë realizuar 368 vizita nëpër shtëpi ku ka të moshuar. Përveç kësaj ofrohet edhe shërbimi paliativ dhe ju lutem kontaktoni DSH-në për ta shfrytëzuar këtë shërbim.

Sevil Kazazi:

Projekti që po e pritni është në përfundim është ndarë një buxhet 80.000 euro për Qendrën Kulturore Turke.

Qytetar nga Zhuri

Kur ka në plan komuna të ndajë një fond për ndërtimin e varrezave të dëshmoreve në fshatin Zhur?

Kur do behet zgjidhja e mungesës së ujit për qytetarët e fshatit Zhur?

Leonora Çerreti,

Besoj se gjate vitit vijues DSHP-ja do angazhohet për zgjidhjen e këtyre problemeve në Zhur dhe unë do angazhohem që t'i njoftoj më kërkesat tuaja

Ramush Rushitit nga klubi i basketbollit

Pjesa dërmuese e komunitetit sportiv ka nevojë urgjente për infrastrukturë sportive. Salla e basketbollit ne Qendrën Sportive është e ster-ngarkuar dhe apeloj qe komuna sipas mundësive te na krijojë mundësi per një salle alternative.

Arhim Ajazi

Qendra Sportive vetëfinancohet dhe komuna nuk mund te liroj klubet nga pagesa, sa i përket sallave tjera konsideroj se mund të ju mbështesim për zhvillimin e aktiviteteve tuaja, kuptohet aty ku kemi mundësi që të ju ndihmojmë.

Qytetar

Kur do funksionalizohet shtëpia kulturës ne zhur?

Arhim Ajazi

Shtëpia e kulturës ne Zhur është nen hetime tani per tani dhe ne duhet presim derisa te përfundoj procesi gjyqësor.

Besim Kodra:

Pse komuna e Prizrenit ka ndërprerë dhënien e infuzioneve në qendra ambulatorë. DSH-së, ju kemi drejtuar me shkresë, pse është ndërprerë dhënia e infuzioneve, meqë ne komunat tjera ky shërbim ofrohet në ambulanca. A keni planifikuar qe ne te ardhmen te rikthehet dhënia e këtij shërbimi sepse nevojat e pacienteve janë mëdha?

Leonora Çerreti:

Po e marr përgjegjësinë me e përcjell shqetësimin tuaj në DSH-ë, dhe besoj se ata do ju përgjigjen saktësisht ju.

Ensar Tara, kryetar i Asamblesë Komunale në Prizren.

Gjatë këtij viti Asambleja Komunale e fëmijëve si problem primar e ka konsideruar pasigurinë e fëmijëve në shkolla, kërkohet qe urgjentisht të parandalohet fenomeni i vrasjes së bashkëmoshatareve në shkolla. Po ashtu e kemi edhe një kërkesë së në komunën tonë është vetëm një person që merret me të drejtat e njeriut, andaj kërkoj nga komuna që të rrisë personelin për këto kategori të shoqërisë. Kërkojmë nga komuna që të punësoj edhe një person për të drejtat e fëmijëve.

Sefedin Kaqamaku, Autom-Moto Klub

Ne kemi përkrahje nga komuna dhe ju falënderojmë, po ashtu kërkoj nga komuna ndonjë projekt në eko-turizem dhe shtigje të reja për gara automobilistike ku do vinin edhe garues ndërkombëtar..

Kërkoj edhe buxhet për mirëmbajtjen e rrugëve ku mbahen garat e automobilizmit.

Resmije Krasniqi, nga shoqata “HADER”

A mund të keni ndonjë buxhet për OJQ-në HADER, ngase kemi nevojë për mbajtjen dhe kujdesin 24 orë, të personave me nevoja të veçanta.

Leonora Cerreti

Do t'i shohim mundësitë që të ju mbështesim edhe në të ardhmen, përndryshe shoqata juaj është përkrahur më së shumti nga komuna jonë vitin e kaluar.

Të nderuar qytetarë faleminderit për kontributin tuaj sot dhe do dëgjohemi e shihemi në debatet vijuese.

Më poshtë gjeni linkun e debatit: <https://www.youtube.com/watch?v=FfYle6G443Y>

Faleminderit!